

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “pjese kembimi Shërbim mirembajtje mjetet dhe eskavatores”

**Marreveshje Kuadër - me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat të marrëveshjes kuadër 12 muaj.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
**50000000-5**

#### **I.1 VLERE E FONDIT LIMIT:**

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total) për të dy lotet:

**9.415.883** (nëntë milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre ) lekë pa tvsh

##### **Loti I: Shërbim mirëmbajtje mjetet**

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total):

**4.102.503** (katër milion e njëqind e dy mijë e pesëqind e tre) lekë pa tvsh

##### **Loti II: Shërbim mirëmbajtje eskavatorët**

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total):

**5.313.380** (pesë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit është llogaritur bazuar në Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IX, “Rolet dhe Përgjegjësitë në Autoritetin Kontraktor” Kreu X, “Zhvillimi i Procedurave ” Neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 1 b).Me urdher nr.268,269 prot. date 31.05.2023 është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit I cili pasi ka testuar tregun ka marrë mesataren e cmimeve nga ky studim dhe ka përllogaritur fondin limit të kontratës që prokurohet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbytjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

c. *Formulain e ofertes sipas shtojces 1 dhe listen e cmimeve sipas shtojces 2*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2020,2021 ,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit per secilin prej loteve / shumatores se loteve per te cilen konkurron.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.*

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2020 ,2021,2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

*Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2023 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.*

*\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **LOTI 1 Sherbim mirembajtje mjetet**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) Shërbime të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës për secilin prej loteve / shumatores së loteve, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Ose**

b) Shërbime të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i lotit / shumatores së loteve që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik të deklarojë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit se ka në dispozicion për kryerjen e shërbimeve :

- Pike servisi në pronësi ose me qira .

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

a. Për piken e servisit në pronësi të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm

-Certifikatë pronësie

-Kopje harte

-Kopje karte

b. Për piken e servisit me qira të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm

- Kontrate qiraje te vlefshme per periudhen e realizimit te mareveshjes kuader
  - Çertifikatë pronësie
  - Kopje harte
  - Kopje karteles
- Vendndodhja e pikes te servisit te Operatorit Ekonomik pjesëmarrës sipas adreses të deklaruar ne QKB duhet te jete brenda territorit te autoritetit kontraktor,Bashkia

**Argumentimi** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti Kontraktor ka nje aktivitet te perditshem dhe makinat duhet te jene gjithmone ne gjendje pune per te sherbyer ne cdo moment.

Difektet e ndryshme qe mund te ndodhin mund te jene shume serioze te cilat mund te cojne deri ne bllokim te punes. Per kete arsye, per ne eshte me shume rendesi koha e riparimit te defektit e cila lidhet dhe me distancen e njesise se sherbimit qe do te kete Operatori Ekonomik.

**2.3.3** Operatori duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit qe ka ne stafin e tij te pakten :

- 1(nje) inxhinier mekanik
- 1(nje) motorrist,
- 1(nje) xhenerik,

***“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :***

a. Në lidhje me inxhinierin mekanik, kërkohet që, të paraqesë:

- Diplomën përkatëse (kopje e noterizuar)
- Kontratën e punës. (te vlefshme)

b.Në lidhje me motorristin dhe xhenerikun , kërkohet që të paraqesë:

- Kontratën e punës. (te vlefshme)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4** License për riparim dhe mirëmbajtje te pjesëve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove kod VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë licensat profesionale për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 mjet karroatrec .

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

Kur mjeteve është në pronësi të vërtetuar me :

- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polia e sigurimit e vlefshme
- Foto

Kur mjeteve është me qira duhet të paraqesë :

- Kontrates e qirase të vlefshme.
- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto

*Ne rastin e mjeteve me qira sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për perdorim vetjak por edhe për perdorim nga të tretet.*

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë 6 Rampa për ngritjen e mjeteve

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

- fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.7** Një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashtë) punonjësish për muajin e fundit.

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

- a. Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

**Dhe**

- b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore te punonjesve sipas formatit qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Eshte kerkuar një mjet karroatrec në rastin kur mund të ndodhin defekte në mjetë me qëllim transportimin e tyre deri në pikën e servisit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se pika e servisit eshte e pajisur me sistem kamerash.

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

- Kontrate me 1 kompani sigurimi te vlefshme gjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates.

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një sistem sigurie me kamerame qëllim që mjetet të jenë gjithmonë të monitoruara gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit.

## **LOTI 2 Sherbim mirembajtje eskavatoret**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) Sherbime të ngjashme per nje objekt te vetëm në nje vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës per secilin prej loteve / shumatores se loteve, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

**Ose**

b) Sherbime të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate tre viteve te fundit te jete jo me e vogel se fondi limit i lotit /shumatores se loteve qe prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit se ka ne dizpozicion per kryerjen e sherbimeve :

- Pike servisi ne pronesi ose me qira .

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :**

a. Per piken e servisit ne pronesi te paraqitet dokumentacioni i meposhtem

-Çertifikatë pronësie

-Kopje harte

-Kopje karte

b.Per piken e servisit me qira te paraqitet dokumentacioni i meposhtem

-Kontrate qiraje te vlefshme per periudhen e realizimit te mareveshjes kuader

-Çertifikatë pronësie

-Kopje harte

-Kopje karte

- Vendndodhja e pikes te servisit te Operatorit Ekonomik pjesëmarrës sipas adreses të deklaruar ne QKB duhet te jete brenda territorit te autoriteti kontraktor,Bashkia Maliq.



**Argumentimi** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti Kontraktor ka nje aktivitet te perditshem dhe makinat duhet te jene gjithmone ne gjendje pune per te sherbyer ne cdo moment.

Difektet e ndryshme qe mund te ndodhin mund te jene shume serioze te cilat mund te cojne deri ne bllokim te punes. Per kete arsye, per ne eshte me shume rendesi koha e riparimit te defektit e cila lidhet dhe me distancen e njesise se sherbimit qe do te kete Operatori Ekonomik.

**2.3.3** Operatori duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit qe ka ne stafin e tij te pakten :

- 1(nje) inxhinier mekanik
- 1(nje) motorrist,
- 1(nje) xhenerik,

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :***

a. Në lidhje me inxhinierin mekanik, kërkohet që, të paraqesë:

- Diplomën përkatëse (kopje e noterizuar)
- Kontratën e punës. (te vlefshme)

b. Në lidhje me motorristin dhe xhenerikun , kërkohet që të paraqesë:

- Kontratën e punës. (te vlefshme)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4** License për riparim dhe mirëmbajtje të pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove kod VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 mjet karroatrec .

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :***

Kur mjeteve eshte ne pronesi të vërtetuar me :

- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme

- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polia e sigurimit e vlefshme
- Foto

Kur mjete është me qira duhet të paraqesë :

- Kontrates e qirase të vlefshme.
- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto

*Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.*

**2.3.6** Një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashtë) punonjësish për muajin e fundit.

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :***

- a. Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firmë dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

**Dhe**

- b. Listpagesat** e konfirmuar (*me firmë dhe vule*) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Është kërkuar një mjet karroatrec në rastin kur mund të ndodhin defekte në mjete me qëllim transportimin e tyre deri në pikën e servisit.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pika e servisit është e pajisur me sistem kamerash.

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :***

- Kontrate me 1 kompani sigurimi të vlefshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një sistem sigurie me kamerame qëllim që mjetet të jenë gjithmonë të monitoruara gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit.